

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI KOMUNAL- GJILAN

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|------------------------|--------------------------|
| Nr i Prokurimit | 651-25-7992-5-1-1 |
| Nr i brendshëm | GL 651 25 126 521 |

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i rrugëve në Malësinë e Zhegocit – Gjilan**

ANKESË

Identifikimi i ankuesit:

“R & Rukolli” SH.P.K. & “BENI-COM” SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

18 Qershori, Skenderaj
(Adresa)

Skenderaj
(Vendi)

+383 (49) 309213
(Numri Telefonit)

Ragip Behrami
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

r.rukolli@hotmail.com
(Adresa elektronike)

08.06.2026
(Data e parashtrimit të kërkesës)

41000
(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)



2. Identifikimi i avokatit

Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtoj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) (Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) (Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. **B05 Njoftimi për kontratë - me datë 16/09/2025**
2. **B54 Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 01/10/2025**
3. **B54 Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 03/10/2025**
4. **B54 Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 06/01/2026**
5. **B12 Hapja e ofertave me datë 16/01/2026**
6. **B45 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar 21/05/2026**
7. **B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së 21/05/2026**
8. **Kërkesa për ri-shqyrtim e dorëzuar përmes eprokurimit me datë 26.05.2026**
9. **Vendimi i AK-së i datës 29.05.2026 lidhur me kërkesën për ri-shqyrtim**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. **Neni 1 Qëllimi i ligjit**
2. **Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
3. **Neni 7 Barazia dhe trajtimi / Jo-Diskriminimi dhe Transparenca.**
4. **Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve**
5. **Neni 60 Kriteret për dhënien e kontratës**
6. **Neni 69 Aftësia teknike ose/dhe profesionale pika 6.3**
7. **Dokumentacioni dhe informacioni shtesë 01/022 për prokurimin publik RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

1. Nuk është respektuar **Neni 1 pika 1 e LPP-së**, (Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase dhe transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.
2. Nuk është respektuar **Neni 6 pika 1 dhe 2 e LPP-së**, (Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike" ndërsa AK ka bërë shkelje të këtij neni duke shpërblyer me kontratë një OE i cili është me çmim më të lartë për 497,637.36 Euro apo 34.11 % me shtrenjtë se sa oferta jonë e cila është e përgjegjshme
3. Nuk është respektuar **Neni 7 pika 1 e LPP-së**, (Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminues dhe do të veprojë në mënyrë transparente, duke na diskriminuar ne si OE të përgjegjshëm me çmim më të lirë. AK dhe komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim dhe nuk ka respektuar këtë nen të LPP-së.
4. Nuk është respektuar **Neni 59 dhe Neni 60 i LPP-së**) sepse komisioni i vlerësimit ka obligim ligjor të jetë i paanshëm, transparent dhe të veprojë konform kriterëve të dosjes së tenderit.
5. Nuk është respektuar **Neni 69, Aftësia teknike ose/dhe profesionale**, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2 e Dosjes së tenderit (Pika 2.8).

Vendimi i Autoritetit Kontraktues bazohet në pretendimin se për ekspertin e fushës së mjedisit nuk është dorëzuar diplomë e nivelit të kërkuar apo se ajo nuk përputhet me profilin e kërkuar, të cilin pretendim e kundërshtojmë si në vijim:

Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim për eliminimin e ofertës sonë në procedurën

e prokurimit publik mbi baza tërësisht të pasakta, të paargumentuara dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dokumentacionin e dorëzuar në ofertë, duke krijuar një konstatim të gabuar për mosplotësimin e kriterëve kualifikuese. Arsyetimi i përdorur për eliminim është jo vetëm i pabazuar në prova konkrete, por edhe rezultat i një interpretimi arbitrar dhe të njëanshëm të kualifikimeve profesionale të personelit kyç, konkretisht të diplomës së paraqitur për ekspertin në fushën e mjedisit. Në Dosjen e Tenderit është kërkuar **Inxh. Ambientit me 3 vite përvojë pune ose Bachelor me 5 vite përvojë**, pa u përcaktuar asnjë kufizim mbi fakultetin, programin e studimit apo institucionin akademik lëshues. Në kundërshtim flagrant me këto dispozita të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka ndërtuar një kriter të ri, të pa-paraparë dhe të pa-publikuar më parë, duke kontestuar diplomën **Magjistër të Shkencave Teknike në programin "Inxhinieri e Mbrojtjes së Mjedisit"** nga Universiteti i Prishtinës, e cila përbën kualifikim të avancuar akademik dhe është në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit.

Në dokumentacionin e dorëzuar nga ana jonë kemi paraqitur inxhinierin A.V., i cili posedon titullin akademik **Master i Shkencave Teknike – Drejtimi i Mjedisit**, i cili ka përvojë profesionale mbi 20 (njëzet) vjeçare në fushën e mjedisit si inxhinier dhe ekspert profesional. Inxhinieri i propozuar ka qenë dhe vazhdon të jetë i angazhuar në realizimin me sukses të projekteve në fushën e mjedisit, përfshirë: projekte infrastrukturore dhe mjedisore, hartimin e planeve për menaxhim mjedisor, vlerësime dhe analiza mjedisore, si dhe aktivitete profesionale që ndërlidhen drejtpërdrejt me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Rrjedhimisht, eksperti i propozuar jo vetëm që i plotëson kërkesat minimale të Dosjes së Tenderit, por posedon edhe përgatitje të avancuar akademike dhe përvojë substanciale profesionale që tejkalon kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Eliminimi i ofertës në këto rrethana përbën shkelje materiale të **nenit 59 të LPP-së**, pasi nuk është bërë vlerësim i kapaciteteve profesionale të dëshmuara në ofertë, por është aplikuar një qasje diskriminuese, e cila ka rezultuar në një vendim të padrejtë.

Pas qasjes së kufizuar të ofruar nga Autoriteti Kontraktues në dokumentet e operatorëve ekonomikë, nuk kemi pasur mundësi të kryejmë një analizë të detajuar të këtyre dosjeve duke bërë të pamundur verifikimin në tërësi të dyshimeve tona për parregullsi të tjera eventuale pasi që zyra e prokurimit e Komunës së Gjilanit nuk na ka dhënë qasje as që t'i shohim dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë (një kopje të procesverbalit të qasjes në dokumente po e bashkëngjisim me këtë kërkesë për ri-shqyrtim ku është e shënuar që "**Kanë vërejtje me arsyetimin se dokumentet që nuk ju janë dhënë në kopje fizike nuk është lejuar as ti shikojnë**". Andaj deklarojmë se ne kemi pretendime se në dosjet e tyre ekzistojnë parregullsi dhe mungesë dokumentesh tek kapaciteti ekonomik/financiar dhe kapaciteti teknik/profesional.

Në përgjigjen e AK-së në kërkesën tonë për ri-shqyrtim, AK-ja ka dhënë arsyetimin si në vijim:

Ne baze të kërkimeve tona si si komision rrezulton se Diploma per inxhinier te Ambientiti lëshohet vetëm nga Fakulteti i Ndertimtaris ne Republikën e Kosoves .

që tregojnë se AK-ja nuk ka bërë vlerësimin bazuar në zbatimin e dispozitave të LPP-së për trajtim të barabartë pasi që ka mundur që të vërtetoj diplomën e A.V. e cila është lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për programin studimor "Programi Inxhinieri e Mbrojtjes së Mjedisit" që është plotësisht sipas kërkesës në dosjen e tenderit.

VENDIM

Bazuar në faktet dhe argumentet e mësipërme, në përputhje me Nenin 108 të LPP-së (Procedurat e rishqyrtimit), kërkojmë:

Aprovojë ankesën tonë si të bazuar;

Anulimin e vendimit për eliminimin e ofertës sonë,

Rishqyrtimin e të gjithë procesit të vlerësimit të ofertave dhe rivlerësimin konform dispozitave ligjore.

Ne, si Operator Ekonomik ankues, të shpërblehemi me kontratë pasi që konsiderojmë se jemi OE më i lirë i përgjegjshëm dhe që plotësojmë të gjitha kushtet e kërkuara.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

1. Dëmet dhe humbjet materiale qysh nga dita e ofertimit, analizës së materialit, deri tek ushtrimi i ankesës.
2. Dëmi financiar dhe humbja e fitimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

**Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues*